

MIRATOHET


SEKRETAR I KKTKM

JOLI MITROJORGJI

## Relacion

### Rishikim Projekt restaurimi

### Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan



# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

## A. Vendndodhja

Monument Kulture i Kategorise I


Gjinia: Ndertime te arkitektures vernakulare

Vendndodhja: Fshati Turan

Shpallur: me vendim NR.1886/dt.10.06.1973 me institucion te shpalljes "Ministria e Arsimit dhe Kultures"

Fshati Turan eshte ndertuar ne fushe rreth 5 km ne jug te qytetit te Korces .

Kulla ndodhet ne skajin lindor te fshatit Turan, ne një terren të shështë dhe daton prej shek.XIX.



## B. Historiku dhe te dhenat arkitektonike


Ajo ,sikurse edhe dy kullat e tjera te kesaj zone nga ana arkitektonike perfaqesojne tipin e zakonshem te kules , me planimetri katrore, me permasa te vogla me nga nje ambient ne cdo kat dhe me theksim ne lartesi.

Per shkak te vlerave historike dhe arkitektonike, kjo kulle eshte shpallur Monument Kulture ne vitin 1973 nga Ministria e Arsimit dhe Kultures.

SKICA TE REALIZUARA NE VITET 1964 DHE NE VITIN 1975

SKICA TE REALIZUARA NE VITIN 1964

SKICA TE REALIZUARA NE VITIN 1964



Materiali nga arkivi IMK .  
Viti 1964 dhe 1975 (nuk kemi informacion nese ka projekt te miratuar)



### **Pershkrim arkitektonik**

Kulla ka një planimetri katrore, me përmasa të vogla me nga një ambient në çdo kat dhe me theksim në lartësi. Volumi i saj i mbyllur, strehët e gurta të pazhvilluara, mungesa e dritareve dhe lakonizmi në elementët arkitektonik flasin vetëm për mbrojtje. Kulla ka një sipërfaqe prej 46.575 m<sup>2</sup> me dimensione 6.75 x 6.9 m, lartësi rreth 15m. Ajo ka një hyrje të vetme që mbulohet me dy harqe guri të vendosur në anë të fasadës perëndimore e cila komunikon me katin e parë. Për të arritur pragun duhet të ngjisje disa këmbë shkallë të drunjta, të cilat nuk ruhen më.

Ngjitja për në katin e dytë bëhet me shkallë guri ndërsa në katet e tjera me shkallë druri. Kati i parë shërbente si depo për prodhimet bujqesore, ndërsa kati i dytë ishte ambienti kryesor i luftimit, i errët, pak më i ulët se katet e tjera dhe pa asnjëfarë komoditeti, ai është i paisur më së miri me frengji për armë zjarri. Dy prej tyre ndodhen në murin lindor, njëri në murin jugor dhe një tjetër në anën perëndimore. Në katin e tretë ndodhet ambienti kryesor i banimit, ai përbëhet nga një kthinë, e cila ndriçohet nga tre frëngji të vendosura në mesin e murit lindor jugor dhe në skain verior të murit prëndimor. Në qoshen verilindore të kësaj kthine ndodhet një ambient sanitar me përmasa 1.82 x 1.12m. Dyshemeja e këtij ambjenti mbështetet mbi një konsol të përbërë nga disa rreshta gurësh që dalin me shkallëzime nga muri verior dhe lindor i kullës. Konsoli fillon në katin e dytë të kullës dhe përfundon në nivelin e dyshemesë së katit të tretë. Ambienti sanitar ka patur një portë nga ana perëndimore dhe ndriçohet nga një dritare e vogël katrore nga ana veriore. Kati i katërt është pak më i lartë nga katet e tjera.

### **Pershkrim Konstruktiv**

Kulla ndahet në katër kate. Secili kat përbëhet nga një ambient i vetëm me përjashtim të katit të parë i cili përbëhet nga dy kthina katërkëndëshe të mbuluar me qemer cilindrik. Katet e tjera ndaheshin nga njëri tjetri me dysheme druri, prej të cilëve sot ruhen vetëm gjurmët e trarëve mbi të cilët ato mbështeteshin. Kati i sipërm është mbuluar me kupole sferike, të mbështetur mbi katër trompa. Kupola mbulohet nga një çati katërujës mbuluar me rrasa guri.

Kupola është ndërtuar me gurë smërçi, katërkëndësh të vendosur në rreshta, të cilët krijojnë rreshta koncentrikë që zvogëlohen në drejtim të kulmit. Në murin lindor dhe perëndimor ndodhen dy dritare të mëdha të mbuluara me hark me majë. Në këtë ambient gjysëm të hapur ndodhën gjurmet e një oxhaku të thelluar në formë gjysëmrrrethi në mesin e murit jugor. Prania e këtij oxhaku të bën të mendosh që ky ambient shërbente për të gatuar gjatë verës. Streha nuk del më tepër se 15cm dhe muret qarkohen me një kornizë guri të punuar, smërçi.

Muret e katit të parë kanë një trashësi 1.15m. në katet e sipërme ato ngushtohen 10-15cm me përjashtim të katit të katërt i cili ka të njëjtën trashësi me katin e tretë.



## Rishikim projekti: Restaurimi i Kullës ne fshatin Turan

Muret e kullës janë të ndërtuar me gure të lidhura me llaç dhe janë forcuar me breza druri. Gurët janë vendosur në rreshta të rregullt horizontal. Ato janë prej formacioni ranor. Nëpër qoshet e mureve kanë formë karakteristike dhe sipërfaqe të punuar, ndërsa në pjesët e tjera janë gjysme të punuara. Llaçi është i përzier me zhavor të imët. Brezat e drurit janë vendosur çdo 70cm dhe lidhen me breza terthorë të vendosur 70-80cm larg njeri-tjetrit. Nga ana e brendëshme e murit brezat, si transversal ashtu edhe terthor janë lënë në sipërfaqe të murit ndërsa nga ana e jashtme e mureve ato nuk duken.

### C. Nderhyrjet nder vite

Gjate viteve kulla ka pasur demtime , si rrjedhim ka pasur disa nderhyrje restauruese .


- **Nderhyrjet restauruese ne vitin 2004**

#### NDERHYRJET NDER VITE

1-Periudha e ndertimit - Nga te dhenat historike kullat si ndertime mbrojtese te vecuara permenden ne pellgun e Korces qysh nga shek. XV. Ne fushen e Korces ruhen ne gjendje te mire tre kulla , kulla ne fshatin Turan Malavec dhe Dishnice. Kulla ne fshatin Dishnice ruhet ne gjendje mire kurse ne dy kullat e tjera jane kryer nderhyrje restauruese ne vitet 1963-1964.

2-Viti 1964 - Nga te dhenat arkivore per kullen e Turanit ne vitet 1964 jane bere rilevime dhe skica te objektit te cilat perfshijne planimetri , pamje , prerje te kullës dhe mund te kete pasur nderhyrje restauruese per te cilat nuk disponojme informacion te sakte.

3-Viti 2004 - jane kryer punime restauruese te cilat perfshijne restaurim murature e rrezuar , ndertim skelarie nga jashte dhe ne brendesi, restaurim catie dhe kornizes nen cati, dhe pastrime bimesie. Keto punime jane te dokumentuara me foto si me poshte dhe jane ne vleren 1 000 000 leke. Gjithashtu jane vendosur dhe tiranta metalike unazore ne tre nivele.





## Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

Punimet: vendosja e tirantave ne tre nivele




D. Dokumentimi grafik dhe fotografik

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE / EKSTERIER







## Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE / INTERIER



## Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

FOTO TE INTERIERIT 2025




## Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

FOTO TE EKSTERIERIT 2025




# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

PLANI I PODRUMIT



PLANI I KATIT PERDHE





### E. GJENDJE EKZISTUESE

Kulla e Turanit ndodhet ne gjendje te amortizuar ne pjesen me te madhe te elementeve te saj.

**Faktoret kryesore te problematikave ne objekt jane:**

#### 1-Termetet

Objekti ka nje planimetri simetrike me nje shtirje ne plan pothuajse katrore duke bere qe te kemi perputhje te qendres se inercise me qendren e rendeses , kjo ka ndikuar ne rezistence te mire ndaj termeteve duke i rezistuar per vite te tera veprimit te forcave sizmike.

Megjithate duke qene se kemi te bejme me nje strukture me murature guri me lartesi te konsiderueshme , murature ka pesuar carje vertikale dhe diagonale ne te gjitha fasadat , devijime te muratures ne pjesen e siperme , carje ne qemerin e podrumit , carje ne qemeret e dritareve ne anen lindore dhe perendimore si dhe demtime ne kupole te cilat kane ardhur si pasoje e levizjeve te muratures .

Nje faktor tjetër i rëndësishëm është dhe veprimi i agjenteve atmosferike te cilat ndikojne ne avancimin e metejshem te ketyre carjeve.

**Si pasoje e termeteve te ndodhura se fundmi ( dt.1 , 2 qershor dhe 31 korrik 2019 ) , kulla ka pesuar demtime te metejshme, si thellim te carjeve dhe vazhdimin e renieve te gureve ne pjeset ku ka pasur renie te muratures.**

#### 2-Mungesa e nderkateve

Sipas shkrimeve mendohet se kullat kane qene me nderkate me dysheme druri por kjo evidentohet dhe nga gjurmet e trareve te dyshemesë te cilat kane mbetur nje pjese e tyre ne murature. Nuk kemi informacion kur mund te jene demtuar nderkatet por nga skicat e vjetra ne arkiven e IMK ne vitet 1964 dhe me vone ne vitin 1975 ne plan dhe ne prerje te objektit nuk jane paraqitur nderkatet domethene kulla eshte pa nderkate qe ne keto vite dhe ne vazhdim.

Mungesa e nderkateve per disa dekada ka sjelle demtime ne muraturen e gurit dhe carje me te medha pasi muratura eshte e pa lidhur ne nivel horizontal ne nje lartesi rreth 9 m.




# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

## FAKTORET E PROBLEMATIKAVE KYRESORE NE OBJEKT

-FAKTORE : TERMETET , MUNGESA E NDERKATEVE


DEMTIMET: CARJE TE MEDHA NE MURATURE , DEVIJIM TE MURATURES , CARJE TE QEMEREVE DHE DEMTIME NE KUPOLE.




VEPRIMI GJEROR I TERMETIT

DEMTIMET: CARJE DHE DEMTIME NE KUPOLE

CARJE NE MURATURE



PRERJA 0-0



### 3-Demtimi i mbuleses se catise

Nga te dhenat qe disponojme nderhyrjet ne objekt kane qene te pakta , mbulesa e catise eshte demtuar me kalimin e viteve dhe si pasoje e mosmirembajtjes se vazhdueshme per kete arsye lageshtia ka depertuar ne kupolen e objektit dhe ne murature duke shkaktuar shplarje te llacit lidhes dhe renie te muratures se kupoles dhe pjeseve mbeshtetese te saj. Gjithashtu dhe streha e catise eshte e vogel deri ne 15 cm dhe nuk mbron muraturen .



# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

## 4-Veprimi i faktoreve atmosferike dhe mosmirembajtja e vazhdueshme e objektit.

Fugatimi i objektit eshte demtuar nga veprimi i agjenteve atmosferike dhe temperaturave te uleta gjate stines se dimrit.



Brezat e drurit kane pesuar degradim sidomos ne pjeset ku jane ne kontakt me lageshtine.

Ne fasaden lindore ka ndodhur shkeputje e nje pjese te muratures dhe deformim i saj si rezultat i lageshtise dhe degradimit te materialit lidhes nder vite.


### FAKTORET E PROBLEMATIKAVE KRYESORE NE OBJKT

**FAKTORE :** DENTIM I MBULESES SE CATISE , MOSMIREMBAJTE PER NJE KOHE TE GJATE, DEGRADIM NGA VEPRIMI I FAKTOREVE ATMOSFERIKE NE MURATURE.

**DENTIMET:** PRANI LAGESHTIE NE MURATURE, DEGRADIM I LLACIT LIDHES SE MURATURES , RENIE E MURATURES, DEGRADIM I BREZAVE TE DRURIT



### DENTIMET: DEGRADIM I BREZAVE TE DRURIT





*Demtim i brezave te drurit*





FOTO 2019





*Mungese e llacit lidhes dhe fugatimit ne kupole, FOTO 2025*





*Renie e muratures dhe deformim i muratures , FOTO 2019*





**Duke u nisur nga faktoret kryesore qe kane vepruar ne objekt demtimet e evidentuara ne kulle ne menyre te permbledhur jane:**

- Dentim i mbuleses se catise , kupola do verifikohet pas hapjes
- Dentim dhe carje ne kupole
- Renie e muratures ne kupole (renie e nje pjese te kupoles ne anen lindore)
- Deformim i muratures ne pjesen lindore dhe jugore dhe perendimore
- Renie e muratures ne pjesen lindore , renie e gureve ne qoshe, avancim i muratures se rrezuar



## Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

- Carje ne muraturen e kulles ne te gjitha fasadat , avancim i carjeve
- Breza druri te amortizuar
- Shplarje e llacit lidhes
- Dentim i fugatimit

### E. Ndërhyrjet Restauruese

Nderhyrje perforcuese dhe restauruese qe propozohen :

- Sondazhe ne themele dhe sondazhe te carjeve ne murature
- Pastrim dhe fugatim i mureve
- Restaurim mur guri ne fasade , restaurim mur guri ne kreun e murit, resaturim mur guri ne brendesi
- Resaturim qemeri ne dritare dhe kupola ne cati
- Injektme dhe qepje te muratures ne varesi te carjeve
- Injektme dhe qepje ne kupole dhe qemere
- Zevendesim i brezave prej druri te amortizuar
- Restaurim i konstruksionit te catise dhe mbulimit te saj
- Riberje e dysHEMEVE dhe shkalleve te drurit
- Vendosje e tirantave metalike unazore
- Sistemim i ambientit perreth
- Vendosja e sinjalistikave dhe tabelave shpjeguese



# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

PRERJE 0-0





FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE



## - Sondazhe ne themele dhe sondazhe te carjeve ne murature

Perpara fillimit me punimet restauruese do behen sondazhe ne themele per te verifikuar thellesine e themeleve dhe demtimet qe mund te kete themeli.

Eshte menduar qe te behet nje drenazhim nga jashte i objektit per te larguar ujerat ne themele. Gjithashtu berja e trotuarit ne perimter te kulles.

## - Pastrim dhe fugatim i mureve

Nje pjese e fugës eshte e demtuar do behet pastrimi fugës me furce teli dhe riberje e fuqatimit sipas teknikes origjinale.

Gjithashtu do pastrohen te gjitha shkrimet nga ana e brendshme me sprai.

## Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

### - Injektione dhe qepje te muratures ne varesi te carjeve

Carjet ne murature jane te konsiderueshme dhe vertikale ne cdo faqe te muratures, keto carje evidentohen si nga ana e jashtme dhe ne anen e brendshme per kete arsye pas vendosjes se skelarive nga jashte dhe nga brenda do behen sondazhe te carjeve per te verifikuar thellesine e tyre dhe hapjen e tyre ne menyre qe te vendoset dhe menyra e nderhyrjes .

### - Injektione dhe qepje ne kupole dhe qemere

Ne kupole kemi shplarje te llacit lidhes dhe carje nga ana e poshtme e saj per kete arsye me vendosjen e skelave dhe zbulimin e catise do behen sondazhe dhe verifikime per carjet dhe ne pjesen e siperme te kupoles , ne baze te sondazheve do behet dhe perforcimi i kupoles , injektimi i carjeve dhe qepje ne qofte se eshte e **nevojshme me lama inoksi**.

### - Zevendesim i brezave prej druri te amortizuar


Do kryhet verifikim i te gjithe brezave nga ana e brendshme dhe do behet restaurim apo zvendesim i tyre ne varesi te gjendjes se tyre dhe nje pjese e brezave qe mungojne do te ribehen.




# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

## - Restaurim i konstruksionit te catise dhe mbulimit te saj

Mbulesa e catise per arsye te veprimit te agjenteve atmosferike dhe mosmirembajtjes se vazhdueshme duhet te behet zvendesimi i plllocave te gurit dhe kontruksionit mbajtes se saj me te njejtin material si origjinali.



# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan



# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

PRERJE 3-3

PRERJA 3 - 3





FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE



# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

PRERJE 4-4

PRERJA 4 - 4




FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE




## - Riberje e dyshemeve dhe shkalleve te drurit

Per arsye te lidhej s ne nivel horizontal te objektit propozojme riberjen e nderkateve prej druri me trare druri ne gjurmjet ekzistuese ne te njejtin nivel qe kane qene nderkatet.

Dyshemeja eshte me derrase dhe lidhja e nderkateve behet me shkalle druri te vendosura ne te njejtin pozicion me shkallet e gurit, sipas skices te shpjeguar ne projekt.

Traret kryesore ne baze te gjurmeve jane te vendosura cdo 50 cm aks me aks dhe do jene ne dukje .


## -Vendosje e tirantave metalike unazore



## Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan


Propozojme kontrollin e tirantave ekzistuese dhe zevendesimin e tyre. Si dhe vendosjen ne nivelin sipas skices ne projekt te tiranta te reja midis atyre ekzistuese.

VENDOSJA E TIRANTAVE




# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

FASADA PERENDIMORE




## FASADA VERIORE



# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

FASADA LINDORE

FASADA LINDORE




**Shenime:**  
Muratura ka nevojte per sondazhe te carjeve per te percaktuesine e tyre, kjo eshte e pamundur te behet per shkak te lartesis se kulles, propozojme qe perpara fillimit te punimeve pasi te vendosen skelarat te behen sondazhe ne murature per secilin lloq nga qerret dhe qe brenda per te gjitha carjet.  
Muratura ne pjesen e sipërme ka gjetur deformime, devijim nga vertikalesi dhe si rezultat dhe rritje ne rreze te saj. Oksa nga faktorët që mund të kenë ndikuar ne rrezimin e saj janë:  
- prania e lagështisë e cilës sjell rreze të saj  
- lidhja e muretures qe ne ridentim  
- ofrimit dhe levizjet e muretures gjate termatave



# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

## FASADA JUGORE




**Shtesim:**  
 Muratura ne kete faqe ka pasur ndryshje te mepashme per shkak te cilat eshte e nevojshme te behet nje sondazh ne qe te se muratura shite ne gjendje te mire ekuivalente me qe te shitesit e sipërme.  
 Muratura ka nevojë për sondazh të çarjeve për të parë theksin e tyre, qe eshte e pamundur te behet per shkak te lartesis se kulles, propozime qe prepare fillimit te punimeve per te vendosur shiritat te behen sondazhe ne murature per secine faqe nga jehuta dhe nga brenda per te gjitha çarjet.  
 Muratura ne pjesen e sipërme ka pasur deformim, devijon nga vertikali dhe si rezultat dhe kështu ne nje pjesë te saj. Dësht nga faktorët qe mund te kene ndikuar ne rezultatin e saj janë:  
 - përkthje e lagështisë e cilës vjen nga çatia  
 - lidhje e muraturës qe ne ndërtim  
 - sfondimet dhe levizjet e muraturës gjate termiteve




# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan

## PLANI I ÇATISE




# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan


## PLANI I KUPOLES



## PLANI I KUPOLES / Patologjite



## FOTO TE GJENDJES EKZISTUES TE KUPOLES




# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan


## DETAJE TE PROPOZIMIT PER VENDOSJEN E SHKALLES DHE DYSHEMESE

VENDOSJA E SHKALLES DHE DYSHEMESE SE DRURIT  
PREFRJE


VENDOSJA E SHKALLES DHE DYSHEMESE SE DRURIT  
PLANE  
DETAJIMI I SHKALLES DHE TRAREVE TE DYSHEMESE



PLANI I KATIT TE DYTE





PLANI I KATIT TE TRETË






# Rishikim projekti: Restaurimi i Kulles ne fshatin Turan


## DETAJE-DRENAZHIMI DHE TROTUARI



## DETAJI I INJEKIMIT




## PUNTELIMI I HARKUT



**Shënim:**  
Për kryerjen e punimeve të restaurimit të muraturës është e nevojshme të bëhet puntelimi i harkut në mënyrë që të mos kemi rrezikim nga dëmtimi të gurëve të tij.

## DETAJI I QEPJES SE KUPOLES



**Shënime:**

Procesi i qepjes të realizohet me materialin origjinal dhe në rrethet që i kalojnë 3 cm nëkohësejt të shpërndahet me qepjen me shufra inoksi paralel me fuqat dhe bazën e kupolës si në vizatim. Gjithashtu, gjatë procesit të fuqatimit dhe qepjes të nivelohet dhe lidhja të bëhet me ilaç hidraulik në përzierje të saj.

**Punoi:**

Ark.Bruna Arkaxhiu

Ing.Xhuljana Avdoli

Digitally signed by  
Bruna Arkaxhiu  
Date: 2025.07.10  
13:32:35 +02'00'

Digitally signed by  
Xhuljana Avdoli  
Date: 2025.07.10  
12:48:31 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Instituti Kombëtar i  
Trashëgimisë Kulturore  
Date: 2025/09/12 09:53:10 +02'00'  
ac35b1138e296465cae84ccc8bd0a7d698202509120  
9530286040

Digitally signed by  
Joli Mitrojorgji  
Date: 2025.09.12  
09:51:24 +02'00'

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vërtetuar nga Joli Mitrojorgji të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)

